

Dorëzania e Garantuesit - Garancia globale

I. Dorëzania e garantuesit

1. I nënshkruari (1).....

banues në (2).....

garanton personalisht dhe solidarisht këtu,

në zyrën e garancisë së

deri në një shumë maksimale prej.....

në favor të Republikës së Shqipërisë, Kosovës, Bashkimit Evropian që përfshin Mbretërinë e Belgjikës, Republikën e Bullgarisë, Republikën Çeke, Mbretërinë e Danimarkës, Republikën Federale të Gjermanisë, Republikën e Estonisë, Republikën e Greqisë, Republikën e Kroacisë, Mbretërinë e Spanjës , Republikën Franceze, Irlandën, Republikën Italiane, Republikën e Qipros, Republikën e Letonisë, Republikën e Lituanisë, Dukatit e Madh të Luksemburgut, Hungarisë, Republikën e Maltës, Mbretërinë e Holandës, Republikën e Austrisë, Republikën e Polonisë, Republikën e Portugalisë, Rumaninë, Republikën e Sllovenisë, Republikën e Sllovakisë, Republikën e Finlandës, Mbretërinë e Suedisë, Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, Republikën e Islandës, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërinë e Norvegjisë, Konfederatën Zvicerane, Republikën e Turqisë (3),

çdo shumë për të cilën personi që e jep këtë garanci (4): mund të jetë apo të bëhet përgjegjës për vendet e përmendura më lart për borxhin në formën e detyrimit doganor dhe pagesave të tjera (5) të cilat mund të jenë ose të kenë lindur në lidhje me mallrat e mbuluara nga operacionet doganore të përcaktuara në pikën 1a dhe/ose pikën 1b

Shuma maksimale e garancisë përbëhet nga shuma prej:.....

(a) duke qenë 100/50/30% (6) e pjesës së shumës referencë që korrespondon shumës së borxhit doganor dhe pagesave të tjera që mund të lindin, e barabartë me shumatoren e shumave të listuara në pikën 1a;

dhe

.....

(b) duke qenë 100/30 % (7) e pjesës së shumës referencë që i korrespondon shumës së borxhit doganor dhe pagesave të tjera që mund të lindin, e barabartë me shumatoren e shumave të listuara në pikën 1b;

1a. Shumat që formojnë pjesën e shumës referencë që i korrespondon shumës së borxhit doganor dhe, kur është e zbatueshme, pagesave të tjera që mund të lindin, janë si më poshtë për secilin nga destinacionet e renditura në vijim (8):

- a) magazinimi i përkohshëm —;
- b) regjim transiti /procedurë transiti të përbashkët — ...;
- c) regjimi i magazinimit doganor — ...;
- ç) regjim i lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimi i importit — ...;
- d) regjimi i përpunimit aktiv — ... ;
- dh) regjimi i përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) — ... ;
- e) nëse ka operacion tjetër — tregoni llojin

1b. Shumat që formojnë pjesën e shumës referencë që i korrespondon shumës së borxhit doganor dhe, kur është e zbatueshme, pagesave të tjera që mund të lindin, janë si më poshtë për secilin nga destinacionet e renditura më poshtë (9):

- a) çlirim për qarkullim të lirë nën një deklaratë doganore standarte pa shtyrje pagese — ...;
- b) çlirimi për qarkullim të lirë nën një deklaratë doganore standarte me shtyrje pagese — ...;
- c) çlirim për qarkullim të lirë nën një deklaratë doganore të depozituar në përputhje me nenin152 të Kodit — ...;
- ç) çlirim për qarkullim të lirë nën një deklaratë doganore të depozituar në përputhje me nenin 165 të Kodit — ...;
- d) regjimi i lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i importit — ...;
- dh) regjimi i përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) — — ... (10);
- e) nëse ka operacion tjetër — tregoni llojin —

2. I nënshkruari merr përsipër të paguajë me kërkesën e parë me shkrim të autoriteteve kompetente të vendeve referuar në pikën 1 dhe pa qenë e nevojshme të shtyjë pagesën përtej një periudhe 30 ditore nga data e aplikimit të shumës së kërkuar, deri në një limit të shumës

maksimale të sipërpërmendur, vetëm nëse ai ose ajo apo ndonjë person tjetër i interesuar përpara datës së skadimit të kësaj periudhe provon, sicc kërkohet nga autoritetet doganore, që regjimi i posacëm ndryshe nga regjimi i përdorimit të vecantë përfundimtar (end -use), është mbyllur, që mbikqyrja doganore e mallrave të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) ose magazinimi i përkohshëm është mbyllur në mënyrë korrekte ose në rastin e operacioneve të ndryshme nga regjimet e posacme, që situata e mallrave është rregulluar.

Me kërkesë të të nënshkruarit dhe për çdo arsye të pranuar si të vlefshme, autoritetet kompetente mund të shtyjnë përtej një periudhe 30 ditore nga data e aplikimit për pagesë periudhën brenda së cilës ai ose ajo është i detyruar të paguajë shumën e kërkuar. Shpenzimet e lindura si rezultat i miratimit të kësaj periudhe shtesë, në veçanti cdo interes, duhet të llogaritet që shuma të jetë ekuivalente me atë që do të tarifohej në rrethana të ngjashme në tregun e parasë ose financiar kombëtar.

Kjo shumë mund të reduktohet nga shumat tashmë të paguara sipas kushteve të kësaj dorëzanie vetëm kur të nënshkruarit i kërkohet të paguajë një borxh të lindur gjatë një operacioni doganor të filluar para datës së marrjes së kërkesës së mëparshme për pagesë ose në 30 ditët vijuese të asaj date.

3. Kjo dorëzani është e vlefshme nga data e miratimit të saj nga zyra e garancisë. I nënshkruari është përgjegjës për pagesën e çdo borxhi të lindur gjatë operacionit doganor të mbuluar nga kjo dorëzani dhe të filluar përpara hyrjes në fuqi të çdo revokimi apo anulimi të garancisë, edhe nëse kërkesa për pagesë është bërë pas kësaj date.

4. Për qëllim të kësaj dorëzanie, i nënshkruari jep adresën e tij ose të saj për shërbim (11) në secilin prej vendeve të referuara në pikën 1 si:

Shteti	Mbiemri dhe emri, emri i shoqërisë dhe adresa e plotë

I nënshkruari pranon se e gjithë korrespondenca dhe njoftimet dhe çdo formalitet ose procedurat në lidhje me këtë dorëzani të adresuara atij/asaj ose të bëra në adresëtë të tij/saj për shërbimet do

të pranohet si e dorëzuar në mënyrë të rregullt.

I nënshkruari pranon juridiksionin e gjykatës në vendin ku ai ose ajo ka një adresë për shërbim.

I nënshkruari merr përsipër të mos ndryshojë adresën e tij ose të saj për shërbim ose, në qoftë se ai ose ajo duhet të ndryshojë një ose shumë nga ato adresa, duhet të njoftojë më parë zyrën e garancisë.

E kryer në.....

më.....

.....

.....

.....

(Nënshkrimi) (12)

II.Miratimi nga zyra e garancisë

Zyra e garancisë.....

Dorëzania e garantuesit e miratuar më.....

.....

(Vula dhe Nënshkrimi)

- (1) Mbiemri dhe emri ose emri i shoqërisë.
- (2) Adresa e plotë.
- (3) Fshini emrin, /emrat e shtetit/shteteve në territorin e të cilëve nuk mund të përdoret garancia.
- (4) Mbiemri dhe emri ose emri i shoqërisë dhe adresa e plotë e personit që siguron garancinë.
- (5) E zbatueshme në lidhje me pagesat e tjera që kanë të bëjnë me importin ose eksportin e mallrave ku garancia përdoret për të vendosur mallrat nën regjimin e tranzitit/procedurën e tranzitit të përbashkët ose mund të përdoret në më shumë se një Shtet Anëtar ose Palë Kontraktuese.
- (6) Fshini atë që nuk zbatohet.
- (7) Fshini atë që nuk zbatohet.
- (8) Procedura të ndryshme nga tranziti i përbashkët që zbatohet vetëm në Bashkimin Evropian .
- (9) Procedura të ndryshme nga tranziti i përbashkët që zbatohet vetëm në Bashkimin Evropian.
- (10) Për shumat e deklaruara në deklaratën doganore për regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use).
- (11) Nëse, në legjislacionin e një shteti, nuk ka një dispozitë për adresë shërbimi, dorëzuesi do të caktojë, në këtë shtet, një

përfaqësues të autorizuar për të marrë çdo lloj komunikimi që i adresohet atij dhe njoftimi sipas nënparagrafit të dytë dhe dorëzania sipas nënparagrafit të katërt të paragrafit 4, të parashikuar në Aneksin 32-01 të VKM nr.446/2017, duhet të bëhen që të korrespondojnë. Gjykatat e shteteve ku ndodhen adresat e shërbimit të dorëzuesit ose të agjentëve të tij do të kenë jurisdiksion në rast mosmarrëveshje në lidhje me këtë garanci.

*(12)Personi që nënshkruan dokumentin, përpara nënshkrimit të tij/saj, duhet të shkruajë me shkrim dorë si më poshtë:
'Garanci për shumën e ...' (shuma e shkruar me fjalë).*
